



Raport i Transparencës 2017-2018

Informacion per vitin fiskal 01/01/2017-31/12/2017 dhe 01/01/2018-31/12/2018

FILTO AUDITING Sh.p.k.

Përmbajtja

Hyrje	3
Struktura ligjore	4
Politikat e kontrollit të cilësisë	5
Sherbimet qe Ofrojme	6
Cilësia e Auditimit	7
Cilësia e Ofritit të Shërbimeve në Taksa	7
Cilësia e Shërbimeve të Konsulencës	7
Njerëzit dhe kultura	Error! Bookmark not defined.
Informacione financiare	8
Njësi ekonomike me interes publik (NIP)	9

Hyrje

Kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin e transaprencës të Filto Auditing shpk për vitin 2017 dhe 2018.

“FILTO Auditing” sh p k është një kompani shqiptare me qendër në Tiranë, e përkushtuar ndaj profesionalizmit dhe efijencës në ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe konsulencës.

Qasja jonë është përputhshmëria e cilësisë së shërbimeve me ambiciet e klientëve tanë, sado të mëdhej apo të vegjël që ata janë, për të punuar së bashku në partneritet dhe për të kërkuar së bashku zgjidhjet e duhura duke i mbeshtetur ata që te behen te suksesshem. Ne punojmë ngushtësisht me stafin drejtues të klientëve për të kuptuar më mirë vështirësitë që këto kanë dhe më pas marrim një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme. Suksesi ynë i vazhdueshëm mbështetet në përvojën tonë të gjerë e cila, së bashku me stafin tonë, formon bazën e aftësisë për të ndihmuar çdo klient në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për më shume se trembedhjete vite, ne ofrojmë shërbime drejt një numri të madh klientësh brënda vendit, duke bashkuar praktikat kombetare dhe ndërkombëtare me njohuritë dhe eksperiencën tonë.

E themeluar në Tiranë në shkurt të 2006, “FILTO-Auditing” është një kompani private e pavarur dhe dinamike dhe së fundmi ka punuar në auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, shërbime të tjera siç përshkruhen më poshtë, dhe trajnime në Shqipëri dhe Kosovë.

Partnerët tanë janë antarë të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

TATJANA FILTO
AUDITUES LIGJOR
ADMINISTRATORE
FILTO AUDITING sh.p.k

Struktura ligjore

Filto Auditing sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 4.01.2008.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Zj. Tatjana FILTO në masën 100% .

Organet drejtuese dhe manaxhimi

Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një kulturë të fortë të përsosmërisë dhe etikës. Partnerët tanë vendosin përkushtimin e tyre në biznes dhe motivojnë stafin për të arritur standardet më të larta të sjelljes dhe performancës.

Shoqëria administrohet nga Zj. Tatjana FILTO, ortak i vetemshoqërisë dhe auditues ligjor i regjistruar në Shqipëri.

Pjesë e shoqërisë për vitin 2017 dhe Janar-Korrik 2018 janë dyauditues ligjorë të rregjistruar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Republikën e Shqipërisë:

- Zj. Tatjana FILTO
- Zj. Arjana REÇI

Politikat e kontrollit të cilësisë

Qëllimi ynë është të vendosim sisteme rigoroze të cilësisë të dizenuar për të na dhënë siguri të arsyeshme që shoqëria dhe punonjësit e saj të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë.

Pavarësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga shoqëria janë faktorë shumë të rëndësishëm për të ardhmen e aktivitetit. Prandaj, ne kemi hartuar dhe implementuar një sërë politikash dhe procedurash në lidhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e kontrollit të brendshëm, masat e vlerësimit të riskut dhe sistemet e monitorimit që sigurojnë që të gjithë ne jemi në përputhje me standardet e larta që kemi vendosur - standardet që klientët tanë presin.

Shoqëria ka procedura të menaxhimit të cilësisë, të cilat përfshijnë:

- ✓ Manualet teknike dhe proceduriale - për të siguruar që shërbimi të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme me standard të lartë;
- ✓ Trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm të partnerëve dhe punonjësve nepermjet trajnimit te IEKA-s;
- ✓ Vlerësim vjetor të stafit.

Shërbimet që Ofrojmë

Ne ofrojmë një portofol shërbimesh auditimi dhe konsulence për një bazë të diversifikuar klientësh. Shërbimet tona kryhen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Ne mund t'ju asistojmë në auditim, kontabilitet, konsulencë, përgatitje, implementim, monitorim dhe vlerësim të organizatave, projekteve në:

- ✓ Auditim të pasqyrave financiare dhe kontroll ligjor të llogarive
- ✓ drejtim, pjesëmarrje dhe përgatitje të raporteve financiare mujore dhe vjetore në përputhje me SNRF-të dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit,
- ✓ drejtim pjesëmarrje dhe mbështetje menaxhimi në punët e auditimit
- ✓ këshilla ligjore dhe taksash
- ✓ drejtim dhe pjesëmarrje të projekteve të punës së auditimit të brendshëm
- ✓ vlerësime të specializuara, analiza, plane biznesi, monitorim dhe vlerësim
- ✓ projektim dhe ofrim të trajnimeve të auditimit të brendshëm, shërbimeve financiare dhe auditimin menaxherial
- ✓ përkthim, interpretim dhe editim të punimeve të specializuara.

Cilësia e Auditimit

Ne në Filto Auditim jemi të përkushtuar ndaj cilësisë në shërbimet që ofrojmë. Për këtë ne jemi angazhuar përmes zhvillimit të politikave dhe procedurave të përfshira në manualin e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, kontrollit të cilësisë, pavarësisë dhe etikës.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Filto Auditing kryhet të paktën një herë në tre vjet. Procesi i Rishikimit të Cilësisë së Auditimit është hartuar për të monitoruar pajtueshmërinë e ekipit të angazhimit me standardet profesionale të auditimit dhe të etikës.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Filto Auditing kryhet nga partnerë të pavarur dhe të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme. Përmes procesit të inspektimit shqyrtohen pasqyrat financiare, raportet e auditimit, letrat e punës dhe dosjet e angazhimit. Partneri i cili kryen Rishikimin e Cilësisë së Auditimit vlerëson nëse ekipi i angazhimit ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme dhe raportet e lëshuara nga firma anëtare janë të përshtatshme në rrethanat e caktuara. Këto përfshijnë përgjegjësitë e udhëheqjes për cilësinë, etikën dhe pavarësinë, pranimin dhe vazhdimësinë e klientëve, burimet njerëzore, ecurinë e angazhimit dhe monitorimin.

Cilësia e Ofritit të Shërbimeve të Konsulencës të Raportimit Financiar dhe Taksave

Shërbimet në fushën e raportimit financiar dhe taksave konsiderohen si një çështje e rëndësishme për shumicën e shoqërive ndaj dhe ne në Filto Auditing i kushtojmë një vëmendje të veçantë ofritit të shërbimeve me cilësi të lartë.

Mjedisi për planifikimin e taksave po bëhet gjithnjë e më tepër politik dhe i një profili të lartë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se ky mjedis dinamik nënkupton se klientët tanë kanë nevojë të vazhdueshme për konsulentë të besueshëm të cilët mund të adresojnë të gjitha nevojat e tyre në lidhje me legjislacionin tatimor, raportimin financiar dhe planifikimin tatimor.

Në vitet 2017 dhe 2018 ne u përqendruam në përmirësimin e aftësive dhe ekspertizës së punonjësve tanë përmes programeve të trajnimit dhe në përforcimin e procesit tonë të rishikimit me qëllim ofrimin e shërbimeve më profesionale.

Cilësia e Shërbimeve të Konsulencës dhe të tjera

Shërbimet tona të konsulencës ndihmojnë klientët të krijojnë, transformojnë dhe mbrojnë vlerat e tyre. Gjithashtu ne ndihmojmë klientët tanë të financojnë rritjen dhe optimizojnë operacionet e tyre, ne i këshillojmë ata se si të menaxhojnë riskun dhe mjedisin rregullator.

Informacione financiare

Ndarja e të ardhurave të Filto Auditing sh.p.k për vitin 2017 dhe 2018 është si në vijim:

Shërbimi	për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 <i>(të ardhurat në mijë lekë)</i>	për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 <i>(të ardhurat në mijë lekë)</i>
Auditime	9,293	10,486
Kontabilitete	800	880
Të tjera	1,599	2,140
Totali	11,692	13,506

Shpërblimi i partnerëve

Partneri paguhet në bazë të pagës vjetore. Përveç kësaj, partneri merr edhe dividendë.

Njësi ekonomike me interes publik (NIP)

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat Filto Auditing Shpk ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (audituar gjate vitit 2017) është dhënë në vijim.

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat Filto Auditing Shpk ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31.Dhjetor 2017 (audituar gjate Vitit 2018) është dhënë në vijim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10 091 datë 5.03.2009 ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe me ligjin 47/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", te ndryshuar

“Njësi ekonomike me interes publik” janë:

- ✓ të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- ✓ bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- ✓ shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- ✓ shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2017 Filto Auditing Shpk kreu auditimin për entitet me interes publik per Pasqyrat Financiare te Vitit 2016 si më poshtë:

Shoqëria	Aktiviteti
PLATINIUM Investements	Subjektet e tjera financiare jobankare te licensuar nga Banka Shqiperise
M-PAY	Subjektet e tjera financiare jobankare te licensuar nga Banka Shqiperise

Gjatë vitit 2018, Filto Auditing Shpk kreu auditimin për entitet me interes publik per Pasqyrat Financiare te Vitit 2017si më poshtë:

Shoqëria	Aktiviteti
PLATINIUM Investements	Subjektet e tjera financiare jobankare te licensuar nga Banka Shqiperise
M-PAY	Subjektet e tjera financiare jobankare te licensuar nga Banka Shqiperise
WVP Fund Management Tirana	Shoqerite administruese fondeve te investimeve kolektive